



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Security Code” Sh.P.K. të datës 29.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Security Code” Sh.P.K. të datës 29.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Security Code” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Security Code” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 29.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:** *“OE fitues nuk ka ngarkuar qarkullimin vjetor për 3 vitet e fundit e cila është kërkuar me DT si dhe nuk janë përmbushur kërkesat mbi aftësitë teknike dhe/ose profesionale”.*

Fillimisht duhet sqaruar se në këtë aktivitet të prokurimit është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “King Security” Sh.P.K. me çmimin më të ulët të përgjegjshëm prej 32,128.60 euro. Ndërsa parashtruesi në këtë aktivitet është tenderuesi me çmimin më të shtrenjtë (i fundit në mesin e nëntë ofertuesve) në vlerë prej 462,594.72 euro. Pra diferenca mes çmimit të ofertuar nga parashtruesi është 14.4 herë më e madhe se çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar. Kur marrim parasysh se kriteri i dhënies është çmimi më i ulët i tenderuesit të përgjegjshëm atëherë mund të thuhet po ashtu se oferta e parashtruesit për shkak të çmimit dukshëm më të lartë se të gjitha ofertat tjera është renditur si tenderuesi i fundit në tabelën e njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Pra nuk bëhet fjalë për një dallim të vogël por për një dallim përtej substancial.

**Sa i përket pretendimeve ankimore** duhet sqaruar se pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar si në vijim: *“OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit minimum 750,000.00 euro”.* Dëshmia dokumentare për këtë kërkesë të dosjes së tenderit është lista e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 7 të dosjes së tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës t’i bashkangjiten referencat ose çertifikatat për kryerje të punimeve.

Në rastin konkret tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar listën e kërkuar të kontratave të realizuara së bashku me referencat përkatëse duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit.

Sa i përket pjesës së pretendimit ankimor ku thuhet se *“OE fitues nuk ka ngarkuar qarkullimin vjetor për 3 vitet e fundit”* duhet sqaruar se në dosjen e tenderit fare nuk është kërkuar qarkullimi vjetor për 3 vitet e fundit. Pra kjo kërkesë nuk ekziston fare në dosjen e tenderit.

Po ashtu nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti i plotëson kërkesat teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit. Përndryshe parashtruesi nuk ka arritur që të formulojë saktë pretendimin ankimor duke specifikuar se për cilat kërkesa të kapacitetit teknik dhe/ose profesional bëhet fjalë saktësisht (përveç asaj që është shqyrtuar më sipër).

Prandaj pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.